



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

### KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbështetur në nenin 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 48 parag.1 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, nenit 16 të Rregullores për përbërjen, kompetencat dhe rregullat e punës të Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit,

### THËRRAS

Mbledhjen e X-të (dhjetë - mandati VII) të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **30 janar 2023**, duke filluar nga ora **13:15**, në ndërtesën e Komunës, salla e mbledhjeve të Kuvendit, me këtë,

### REND TË DITËS

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 08.12.2022
2. Propozim Rregullore për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi
3. Propozim Rregullore për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës
4. Propozim Vendim për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit
5. Kërkesa – Nisma e procedurës për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunave; Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq
  - Propozim vendim për miratimin e Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal
  - Propozim vendim për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin përkatës të bashkëpunimit ndër-komunal
6. Propozim Vendim për shpalljen në interes publik - pronat që preken nga projekti për ndërtimin e rrugës lidhëse nga magjistratja Prishtinë-Podujevë deri te rruga “Vëllezërit Frashëri”
7. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qytetin e Podujevës
8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike - Kompania Rajonale e Mbeturave “Pastrimi” sh.a
9. Propozim Vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo – arsimore
10. Propozim Vendim - për destinimin e paluajtshmëris për ndërtimin e Qendrës Multifunksionale
11. Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Programi Trevjeçar i Banimit 2023- 2025
12. Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturave 2023-2027
13. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Barazi Gjinore (pas dhënies së dorëheqjes së znj.Drita Pajaziti për shkak të emërimit anëtare në Komitetin për Politikë dhe Financa)
14. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022
15. Delegimi i një anëtari të KPF-së në Ekipin për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Podujevës (Udhëzimi Administrativ (QRK) nr.06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës)

Nr.prot.01-060/03-0005879/23  
Podujevë, datë; 20 janar 2023



Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Hilmi Hoxha